

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 13/2022

përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën në jetë dhe për të siguruar mbrojtje nga dhuna në familje

Për:

Z. Samedin Mehmeti, Drejtor i Policisë së Kosovës

Z. Jetish Maloku, Kryesues i Këshillit Prokurorial

Kopje:

Z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 21 korrik 2022

Qëllimi i raportit

Ky raport është iniciuar sipas detyrës zyrtare bazuar në raportimet e portalit “Gazeta Express”, me titullin: “*Vrasja e gruas në Llaushë të Skënderajt, krejt çka dihet deri tash*”, ku ishte raportua se më 5 janar 2022, në fshatin Llaushë në Skënderaj, ishte gjetur e vrarë me armë zjarri një grua (me inicialet: L.Q.). Në këtë drejtim ishte raportuar se bëhej fjalë për vrasje, duke theksuar se viktima dhe dorasi ishin bashkëshortë për shumë vite dhe nga kjo bashkësi martesore kishin tre fëmijë. Më tej ishte raportuar se L.Q., më 1 janar 2022, e kishte raportuar rastin e dhunës në familje, por dyshohej se autoritetet nuk i kishin ndërmarrë masat e nevojshme dhe për pasojë rasti kishte përfunduar tragjikisht.

Raporti ka për qëllim të vlerësojë përmbushjen e detyrimeve pozitive nga ana e autoriteteve përgjegjëse për të mbrojtur të drejtën në jetë të qytetarëve; t’i analizojë veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve përkitazi me të drejtën për jetë, zbatimin e dispozitave kushtetuese, instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, praktikën e Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, ligjet, politikat dhe strategjitë kundër dhunës në familje.

Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*” Kurse në paragrafin 3 përcakton: “*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.*”
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “*Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).
 - “*Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
 - “*T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
 - “*Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
 - “*Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).

- “T’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

Rrethanat e rastit

3. Më 5 janar 2022, mediat e ndryshme kishin raportuar se në Llaushë të Skenderajt ishte gjetur e vrarë me armë zjarri një grua me inicialet L.Q. Në këtë drejtim, mediat kishin raportuar se dyshohej për vrasje, duke precizuar se viktima dhe dorasi ishin bashkëshortë për shumë vite dhe nga kjo bashkësi martesore kishin tre fëmijë.
4. Në media raportohej se L.Q., më 1 janar 2022, e kishte raportuar rastin e dhunës në familje, por dyshohej se autoritetet nuk i kishin ndërmarrë masat e duhura dhe rasti kishte përfunduar tragjikisht.¹
5. Si reagim shoqëror i kësaj ngjarje u raportua organizimi i një proteste nga OJQ “Gratë Intelktuale të Drenicës”, nën moton: “*Vrasja nuk është virtyt trimërie, por forma më e ulët e ligështisë*”, “*Nëse nuk di të duash mos merr jetë*”, duke kërkuar shkarkimin e komandantit të Policisë dhe të prokurores së rastit.²
6. Po më 5 janar 2022, Policia e Kosovës nëpërmjet faqes zyrtare kishte raportuar: “*Arrestohet një person i dyshuar për veprën penale vrasje e rëndë*”³, duke theksuar se nga hetimet fillestare nga vendi i ngjarjes bëhej e ditur se personi i dyshuar S.Q. kishte shtënë me armë zjarri në drejtim të viktimës (gruas së tij) L.Q., 48 vjeçe, e cila kishte pësuar lëndime të rënda, të njëjtën me urgjencë e kishin dërguar në spitalin rajonal në Mitrovicë. Ndërkohë nga autoritetet spitalore ishte raportuar se viktima nuk kishte arritur t’u mbijetonte plagëve të marra.
7. Më 4 maj 2022, Këshilli Prokurorial i Kosovës nëpërmjet faqes zyrtare kishte njoftuar se kishte marrë Vendimin KPK/Nr.2022, me të cilin prokurores kujdestare ia kishte shqiptuar masën disiplinore “*Vërejtje publike me shkrim*”, për shkak se nuk kishte vepruar në përputhje me Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë, dhe me nenin 6, paragrafi 2, pikat 2.1 dhe 2.5, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.⁴

Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

8. Më 19 janar 2022, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit (AP) kishte kontaktuar me mbrojtësin e viktimave të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), në kuadër të Prokurorisë së Shtetit në Mitrovicë, me të cilin kishte biseduar lidhur me rastin. Nga ai njoftua se ZMNV-ja në Mitrovicë, deri më 1 janar 2022, kur ishte raportuar dhuna psikike,

¹Shih linkun: <https://kallxo.com/lajm/shpjegimi-i-komandantit-te-policise-ne-skenderaj-pse-nuk-u-kerkua-urdhri-mbrojtes-per-gruan-qe-u-vra-ne-llaushe/>

²Shih linkun: <https://paparaci.com/49547/vrasja-ne-llaushe-kerkohet-shkarkimi-i-komandatit-te-policise-dhe-prokurores/>

³<https://www.kosovopolicia.com/arrestohet-nje-person-i-dyshuar-per-vepren-penale-vrasje-e-rende/>

⁴<https://prokuroria-rks.org/kpk/dokumente-publikime/82/93/646/646/>

me herët nuk kishte pranuar ndonjë rast për dhunë në familje nga çifti bashkëshortor në fjalë.

9. Më 20 janar 2022, përfaqësuesi i AP-së kishte kontaktuar me zyrtaren nga ZMNV-ja në Mitrovicë, e cila kishte deklaruar se kishte qenë kujdestare më 1 janar 2022 dhe ishte kontaktuar nga zyrtarja policore për rastet e dhunës në familje e Stacionit Policor në Skenderaj dhe i kishte rekomanduar zyrtares policore të rastit që për çështje sigurie të fliste me koordinatoren regjionale për rastet e dhunës në familje në Stacionin Policor Rajonal Mitrovicë Jugu dhe t'i lëshohej masa për urdhër mbrojtje të përkohshme emergjente, masë kjo e cila lëshohet nga policia, derisa të fillojë punën gjykata. Pastaj zyra regjionale e ZMNV-së, të mërkurën, më 5 janar 2022 kishte pranuar rastin nga policia dhe menjëherë posa kishte filluar punën gjykata ishte proceduar masa për urdhër mbrojtjeje, por që fatkeqësisht në po atë ditë, nëpërmjet mjeteve të informimit ishte kuptuar që kishte ndodhur vrasja.
10. Më 21 janar 2022, përfaqësuesi i AP-së kontaktoi drejtoreshën e Drejtorisë Rajonale të Policisë Mitrovicë Jugu, nga e cila kërkoj të informohet në lidhje me rastin. Ajo deklaroi se për çdo gjë lidhur me rastin do të njoftohej nëpërmjet postës elektronike zyrtare.
11. Po më 21 janar 2022, përfaqësuesi i AP-së i kishte dërguar shkresë Policisë së Kosovës, nga e cila kishte kërkuar informacione përkitazi me të kaluarën kriminale për personin S.Q. përkitazi me dhunën në familje, si dhe një raport informues nga hetuesit e rastit, në kuptim të përshkrimit të rrethanave të ngjarjes së 1 dhe 5 janarit 2022.
12. Më 21 janar 2022, përfaqësuesi i AP-së kontaktoi me drejtorin e Qendrës për Punë Sociale (QPS) në Skenderaj, i cili kishte deklaruar se më 1 janar 2022, rreth orës 15:10, nga Stacioni Policor në Skenderaj ishin ftuar të merrnin pjesë në intervistimin e së ndjerës L.Q., e cila rastin e kishte raportuar si mosmarrëveshje bashkëshortore. Gjatë deklarimit ajo kishte thënë se nga bashkëshorti i saj kishte më tepër dhunë psikike, ndërsa në të kaluarën kishte pasur edhe dhunë fizike, por rastin s'e kishte lajmëruar asnjëherë në polici. Biseda me të ndjerën ishte bërë sipas procedurave standarde dhe pas marrjes së deklaratës viktimat ishte pyetur disa herë nëse kishte nevojë për strehim në strehimore për viktimat e dhunës në familje në Mitrovicë, por e njëjta kishte refuzuar me arsyetimin se kishte përkrahjen nga fëmijët, e posaçërisht nga djali i madh E. Q., i cili gjithashtu ishte shprehur i gatshëm që të kujdesej për nënën. Ndërsa, pas aktit të vrasjes më 5 janar 2022, organi i kujdestarisë i QPS-së në Skenderaj kishte vizituar familjen e cila kishte qenë në përkujdesje të xhaxhait.
13. Më 10 janar 2022, QPS-ja në Skenderaj i ishte drejtuar kryetarit të komunës në Skenderaj me një shkresë për strehim të fëmijëve dhe menjëherë nga kryetari i ishte ndarë një banesë në Skenderaj. Tani fëmijëve është duke iu dhënë ndihma - këshilla psikologjike në qendrën "Diakonie" në Mitrovicë.
14. Më 22 janar 2022, përfaqësuesi i AP-së kontaktoi me ushtruesin e detyrës së drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj, i cili kishte deklaruar se në këtë qendër i dyshuari S. Q. nuk ishte trajtuar asnjëherë te mjeku psikiatër. Po ashtu as e ndjera L.Q., nuk ishte trajtuar në këtë qendër.
15. Më 24 janar 2022, përfaqësuesi i AP-së i kishte dërguar shkresë edhe drejtorit të QPS-së në Skenderaj, nga i cili kishte kërkuar informacione në lidhje me rastin. Në po të njëjtën

ditë, përmes postës elektronike zyrtare, shefi i Shërbimeve Sociale në QPS-në në Skenderaj kishte dërguar shënimin zyrtar mbi rrethanat e rastit nr. 56, datë 12 janar 2022.

16. Më 28 janar 2022, përfaqësuesi i AP-së pranoi përgjigje nga Policia e Kosovës, me ç' rast u njoftua në përgjithësi me rastin, intervistimin, deklaratat e së ndjerës L.Q., raportin e zyrtarit policor, raportin informues hetimorë të datë 5 janar 2022, ku shihej se i dyshuari L.Q. nuk kishte të kaluar kriminale, dhe se rasti i parë për dhunë në familje ishte rasti i datës 1 janar 2022.
17. Më 2 shkurt 2022, Avokati i Popullit i kishte dërguar shkresë kryeprokuroorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë (PThM), nga i cili kishte kërkuar informacione përkritazi me ecurinë e hetimeve të këtij rasti, në fazën në të cilën gjendej procedura, si dhe një kopje nga shkresat e lëndës.
18. Më 24 shkurt 2022, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga PThM-ja bashkë me një shënim zyrtar për rastin (2022-0000553, datë 18 shkurt 2022), si dhe shkresat e lëndës, që sipas Prokurorisë, policia ia kishte dërguar më 6 janar 2022, mbi ngjarjen e ndodhur dhe veprimet policore të Stacionit Policor në Skenderaj më 1 dhe 5 janar 2022. Duke theksuar se më 1 janar 2022, nga Policia e Kosovës - Stacioni Policor në Skenderaj, kjo Prokurori kishte pranuar kallëzimin penal numër 2022-BF-0001, së bashku me shkresat përcjellëse, të parashtruar kundër të pandehurit S.Q., për shkak të veprës penale *dhunë në familje*, kundër bashkëshortes L.Q., tani e ndjerë. Po ashtu më 6 janar 2022, nga Policia e Kosovës - Njësia e Hetimeve Rajonale në Mitrovicë, kjo Prokurori kishte pranuar kallëzimin penal numër 2022-BF-013, së bashku me shkresat përcjellëse, të parashtruar kundër të pandehurit S.Q., për shkak të veprës penale *Vrasje e rëndë dhe mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve*. Më tej kryeprokurori i PThM-së kishte njoftuar se shkresat e lëndës me numër PP.II. 15/22 ishin bartur në Departamentin e Krimeve të Rënda, ku është duke u zhvilluar procedura hetimorë lidhur me rastin.
19. Më 12 prill 2022, Avokati i Popullit nëpërmjet një shkrese kërkoj informata nga menaxheri i zyrës qendrore të ZMNV-së në Prishtinë për veprimet e kësaj zyre në raportimin e viktimës (raportimin e dhunës në familje) më 1 janar dhe po ashtu veprimet më 5 janar 2022 (në ditën kur ka ndodhur vrasja).
20. Më 14 prill 2022, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga menaxheri i zyrës qendrore të ZMNV-së në Prishtinë, bashkë me deklaratën rreth rastit (1 dhe 5 janar), si dhe shkresat përcjellëse të lëndës, duke deklaruar se zyrtarët në Mitrovicë, më 1 janar 2022, janë kontaktuar nga Stacioni Policor në Skenderaj dhe i kanë rekomanduar zyrtares policore të rastit që për çështje sigurie t'i lëshohet masa për urdhër mbrojtjeje të përkohshme emergjente, masë kjo e cila lëshohet nga policia, derisa të fillojë punën gjykatë. Pastaj zyra rajonale e ZMNV-së në Mitrovicë, të mërkurën, më 5 janar 2022, posa ka filluar punën gjykatë është proceduar masa për urdhër mbrojtjeje, por që në po atë ditë nëpërmjet mjeteve të informimit është kuptuar që ka ndodhur vrasja.

Baza ligjore

21. Neni 21, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktojnë si në vijim: "*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut,*

të parashikuara në këtë Kushtetutë, Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”

22. Neni 22 i Kushtetutës përcakton: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”* Kurse neni 23 përcakton: *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”*

23. Neni 25, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton si në vijim: *“Secili individ gëzon të drejtën për jetën [...]”*. Ndërsa neni 26 përcakton: *“Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj [...]”*

24. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 29, paragrafi 1, përcakton: *“Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente si në vijim:*

- *Pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale [...];*
- *Për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë, [...].”*

Kurse neni 53 përcakton:

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

25. Kushtetuta i bën drejtpërdrejt të zbatueshme në rendin ligjor të Kosovës një numër të instrumenteve e marrëveshjeve ndërkombëtare nga fusha e të drejtave të njeriut. Aty është përcaktuar që këto akte zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

26. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 25 shtator 2020, kishte miratuar Amendamentin nr. 26 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të të cilit, Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje (më tej: Konventa e Stambollit) ishte bërë pjesë integrale e Kushtetutës.⁵

27. Konventa e Stambollit, e miratuar më 11 maj 2011, në Stamboll, e cila në nenin 1 [Qëllimet e Konventës] përcakton qartë se qëllimet e saj janë:

“a) Mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës, dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

b) kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave;

c) hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 4/30 shtator 2020, Prishtinë.

d) nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

e) ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.”

28. Konventa e Stambollit, në nenin 5 [Detyrimet e shtetit dhe masat paraprake], paragrafi 1, përcakton: “Palët i shmangen përfshirjes në akte dhune kundër grave dhe garantojnë që autoritetet Shtetërore, zyrtarët, agjentët, institucionet dhe aktorë të tjerë që veprojnë në emër të Shtetit, të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.” Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton: “Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera të nevojshme për të ushtruar masa paraprake për të parandaluar, hetuar, dënua dhe siguruar kompensim për akte dhune të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, të cilat kryhen nga aktorë jo shtetërore.”

29. Në nenin 18 Konventa flet për detyrimet e përgjithshme, ku ndër të tjera në paragrafët 4 dhe 5 parasheh:

4. Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori vepre penale.

5. Palët marrin masat e duhura për të ofruar mbrojtje konsullore dhe mbrojtje dhe mbështetje tjetër për shtetasit e tyre dhe viktimat të tjera që kanë të drejtën e kësaj mbrojtjeje, në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare

30. Konventa e Stambollit, në nenin 55 [Procedimet ex parte dhe ex officio], paragrafi 1, përcakton: “Palët sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente nuk do të jenë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj, dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktimat e tërheq deklarata ose ankesën e tij ose saj.”

31. Në paragrafin e parë të nenit 56 Konventa përcaktohet se: “Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve gjyqësore, në veçanti: a) duke ofruar mbrojtjen e tyre, si dhe atë të familjeve të tyre dhe të dëshmitarëve, nga hakmarrja, kërcënimi dhe viktimizimi i përsëritur [...]”

32. Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (4 nëntor 1950) (në tekstin e mëtejshëm: Konventa Evropiane) përcakton:

“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj [...]”; ndërsa neni 5, paragrafi 1, i kësaj Konvente përcakton: “Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj [...]”

33. Kodi i Procedurës Penale në nenin 7 [Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve] në paragrafin 1 përcakton se : “Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.” Ndërsa në

paragrafin 2 *''Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.''*

34. Neni 1, paragrafi 1, i Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton: *''Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktimë të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.''* Ndërsa paragrafi 2 vazhdon tutje: *''Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.''*
35. Neni 4, paragrafi 1, i Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton: *''Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, mund të shqiptohet kryesisht të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese, me qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të kryerësit apo nëse ekziston rrezik i përsëritjes së dhunës në familje.''*
36. Neni 17, paragrafi 2, i Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton: *''Vendimi për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente ekzekutohet menjëherë me vendim përkatës, i shqiptuar nga Gjykata kompetente dhe i u dërgohet menjëherë kryerësit të dhunës në familje Policisë së Kosovës, qendrave për punë sociale, si dhe palëve të tjera në procedurë.''* Ndërsa neni 27 i këtij ligji përcakton: *''Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me: Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit dhe me atë të Arsimit, është përgjegjëse për mbështetjen dhe për ngritjen e strukturave ndihmëse dhe të infrastrukturës së nevojshme, që shërben për mbështetjen dhe për plotësimin e nevojave të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhuna në familje, përfshirë këtu asistencën sociale dhe shërbimet mjekësore, në pajtim me legjislacionin në fuqi.''*
37. Neni 24, paragrafi 1, i Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton: *''Policia e Kosovës duhet t'i përgjigjet secilit njoftim për veprat ose kërcënimet e dhunës në familje ose shkeljes së urdhrit për mbrojtje apo të urdhrit për mbrojtje emergjente pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin''. Më tej, paragrafi 2 i po këtij neni përcakton: ''Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje, Policia e Kosovës e ndalon kryerësin e supozuar në pajtim me ligjin.''* Derisa paragrafi 4 i po të njëjtit nen përcakton: *''Policia e Kosovës e përpilon raportin lidhur me rastin pavarësisht se a është kryer vepra apo jo, a është ndaluar dikush apo jo dhe një kopje të këtij raporti ia japin viktimës, përfaqësuesit të saj ligjor dhe mbrojtësit të viktimës.''*
38. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016–2020 shpreh angazhimin serioz dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të fenomenit të dhunës në familje ku përcaktohet që fokusi do të jetë në:
- *aktivitete informuese dhe vetëdijësuese që synojnë parandalimin e fenomenit të dhunës në familje;*

- koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të të gjitha palëve pjesëmarrëse për mbrojtjen, trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave nga dhuna në familje;
- ndëshkimin dhe vënien përpara përgjegjësisë të kryerësve të dhunës në familje;
- harmonizimin e legjislacionit kombëtar me atë ndërkombëtar si dhe rishikimin e standardeve të shërbimeve për viktimat e dhunës në familje;
- ndryshimin e mentalitetit dhe kulturës paragjyquese dhe fajësuese për viktimat e dhunës në familje;
- ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe me standarde bashkëkohore, që duhet të jenë të shtrira në vend, dhe në të cilat të kenë qasje të gjithë individët e dëmtuar nga dhuna në familje, pavarësisht karakteristikave të tyre të lidhura me moshën, gjininë, aftësitë apo nevojat e veçanta, identitetin gjinor, orientimin seksual etj.;
- trajtimin e kryerësve të dhunës në familje përmes programeve të obligueshme rehabilituese; si edhe shumë veprime të tjera të planifikuara më konkretisht në këtë strategji.

39. Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje⁶, dokument ky i përpiluar nga Zyra për Barazi Gjinore e Zyrës së Kryeministrit, i detajon masat që duhet t'i ndërmarrë secili institucion gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Ky dokument, në Shtojcën nr. 3 - "*Forma bazike e të dhënave për viktimat e dhunës në familje*" përcakton formën bazike të të dhënave e cila përcaktohet të jetë konfidenciale dhe të jenë në shërbim vetëm për aktorët në procedurë. Në këtë dokument përcaktohen, përveç të tjerash, edhe indikatorët e rrezikshmërisë, të cilët ndahen në indikatorë të rrezikshmërisë së ulët, të mesëm dhe të lartë. Në këtë rast do t'i përmendim vetëm disa nga indikatorët e rrezikshmërisë së lartë, të cilët mund të ishin vlerësuar në rastin në fjalë, respektivisht kur ishte lajmëruar rasti në Stacionin Policor në Skenderaj. Ndër indikatorët e rrezikshmërisë së lartë në Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcaktohen situatat kur:

- Kryerësi e ka kërcënuar viktimën me armë;
- kryerësi e kontrollon çdo aktivitet ditor të viktimës, di çdo detaj rreth viktimës;
- kryerësi nuk e lejon viktimën të shoqërohet me askënd, madje as me familjarët e saj;
- kryerësi e rrah viktimën dhe fëmijët;
- kryerësi e kërcënon viktimën se do t'i lëndojë fëmijët nëse ajo largohet nga shtëpia;
- kryerësi është në gjendje të gjejë lehtë viktimën nëse ajo largohet nga shtëpia;
- kryerësi ka probleme psikologjike. Sjelljet e tij nuk duken të jenë normale etj.

40. Pavarësisht faktit se Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në Shtojcën nr. 9 - "*Lista e Kontrollit për Policinë*", përcaktojnë listën kontrolluese për veprimet policore që duhen ndërmarrë në rastet e mbrojtjes nga dhuna në familje, disa prej pikave kryesore në këtë listë duket se ishin neglizhuar në këtë rast nga zyrtarët përgjegjës në Stacionin Policor në Skenderaj. Kjo listë, përveç të tjerash, përfshin:

⁶<https://abgi.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Procedurat%20Standarte%20t%C3%AB%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20n%C3%AB%20Familje.pdf>

- *Reagimi ndaj rasteve të dhunës në familje;*
- *mbrojtja e viktimës, fëmijëve dhe dëshmitarëve të tjerë;*
- *largimi i kryerësit të dhunës në familje;*
- *plotësimi i formës bazike, vlerësimi i nevojave dhe rrezikut;*
- *transportimi ose sigurimi i transportit për viktimën dhe bartësit e saj/tij në strehimore ose në ndonjë lokacion tjetër të sigurt sipas kërkesës së viktimës;*
- *shqiptimi i urdhrit të përkohshëm emergjent jashtë orarit të punës së gjykatave;*
- *informimi i viktimës për të drejtat e saj/tij;*
- *informimi i viktimës për shërbimet ekzistuese;*
- *shqiptimi i urdhrit të përkohshëm emergjent jashtë orarit të punës së gjykatave, nëse kërkohet nga viktima, QPS-ja, mbrojtësi i viktimave ose strehimorja;*
- *hetimi i rastit të dhunës në familje;*
- *nëse ka elemente të veprës penale, përpilimi i kallëzimit penal dhe referimi i rastit tek prokurori kompetent etj.*

Analiza ligjore

41. Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një përgjigje efektive në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Republikën e Kosovës. Përkundër faktit se Republika e Kosovës ka bërë shumë përpertime në krijimin e mekanizmave reagues ndaj rasteve të dhunës në familje, ka ende aspekte që kërkojnë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën për jetë. Viktimat e dhunës në familje vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme, sidomos nga mosfunksionimi i autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e kësaj dukurie shqetësuese e cila në shumë raste po përfundojnë me fatalitet.
42. Kushtetuta, akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet.
43. Kushtetuta, në nenin 25, paragrafi 1, përcakton: “*Secili individ gëzon të drejtën për jetën.*” Nga ky paragraf shihet qartë se e drejta për respektimin e jetës së qytetarit gjendet në qendër të sistemit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe e drejta për jetën (pacenueshmëria e saj) është e drejtë absolute e njeriut, e cila nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë, si dhe nuk lejohet shmangia nga kjo e drejtë. Shteti ka detyrim pozitiv që t'i ndërmarrë të gjitha masat për ta mbrojtur qytetarin, veçanërisht kur rrezikohet integriteti dhe jeta e njeriut. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në Aktgjykimin KI 41-12, ka gjetur se kishte shkelje të së drejtës për jetë në rastet kur organet kompetente të shtetit nuk u ofronin mbrojtje të mjaftueshme qytetarëve të ekspozuar ndaj dhunës në familje dhe kur për këtë e kërkonin rrethanat e rastit. Gjykata Kushtetuese, gjatë trajtimit të kësaj kategorie të të drejtave, ka proklamuar se e drejta për jetë është e drejta më e rëndësishme prej të gjitha të drejtave njerëzore, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera dhe ka sqaruar

se ekzistojnë detyrime pozitive për organet e pushtetit që të ndërmarrin masa parandaluese dhe operative për ta mbrojtur jetën e të gjithë atyre që i janë ekspozuar rrezikut.⁷

44. Neni 3 i Konventës e definojnë dhunën kundër grave si ``..... si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private.``
45. Sipas Konventës së Stambollit, luftimi i dhunës ndaj grave nuk duhet të kuptohet si një çështje e kontrollit të krimit, por kërkon masa gjithëpërfshirëse që të arrihet një barazi me e madhe midis grave dhe burrave. Vetëm barazia e vërtetë midis grave dhe burrave me të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi, me mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës dhe kur kontributi i tyre në shoqëri vlerësohet dhe respektohet në mënyrë të barabartë bashkë me një ndryshim në dinamikën si dhe qëndrimet e pushtetit, mund të eliminojë me të vërtetë dhunën ndaj grave.
46. Avokati i Popullit rikujton se në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Evropiane).
47. Neni 2 i Konventës Evropiane paraqet detyrimet e përgjithshme të shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetë dhe përfshinë aspektet pozitive dhe negative: a) detyrimin pozitiv për ta mbrojtur jetën; dhe b) detyrimin negativ që të përmbahet nga marrja e paligjshme e jetës. Obligimi pozitiv imponon detyrime të parandalimit dhe hetimit. Detyrimet e parandalimit (shih rastin e Gjykatës Evropiane: *Osmani kundër Britanisë së Madhe, i datës 28 shkurt 1998*) i obligojnë qeveritë e shteteve që t'i pengojnë dhe t'i luftojnë veprat penale. Prandaj, nëse vërtetohet se qeveritë kishin njohuri, ose do të duhej të kishin njohuri në kohën e ekzistimit të rrezikut real dhe të drejtpërdrejtë për jetën e një personi të identifikuar nga veprat penale të palëve të treta dhe nëse nuk kanë ndërmarrë masa të duhura në kuadër të kompetencave të veta, të cilat, sipas një vlerësimi të arsyeshëm, mund të priteshin, në mënyrë që të shmangej rreziku për jetë, të njëjtat duhet të jenë përgjegjëse për moszbatim të detyrimeve pozitive.
48. Në rastin *Tërshana kundër Shqipërisë (nr. 48756/14)* të Gjykatës Evropiane, të datës 4 gusht 2020, edhe pse shteti nuk mbahej përgjegjës për mos ndërmarrjen e veprimeve për parandalimin e sulmit me motive gjinore, për faktin se autoritetet shtetërore nuk ishin në dijeni për problemet e ankueses, megjithatë shteti është mbajtur përgjegjës për hetime joefektive meqenëse kryesi i veprës së sulmit ndaj ankueses nuk u zbulua asnjëherë, duke konstatuar kështu shkelje të nenit 2 (E drejta për jetë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë vendim Gjykata ndër të tjera theksoi se sulmi kishte karakteristikat e dhunës me bazë gjinore dhe se kjo do të ishte arsye që do duhej t'i kishte nxitur autoritetet të reagonin me më shumë përkushtim.
49. Në rastin *Kontrová kundër Sllovakisë (nr. 7510/04)*, viktima e dhunës në familje kishte paraqitur një ankesë penale kundër bashkëshortit të saj për sulm fizik kundër saj. Pas kësaj,

⁷ Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi KI 41/12, neni 57.

ajo, e shoqëruar nga bashkëshorti i saj, kishte shkuar te autoritetet dhe ishte përpjekur ta tërhiqte ankesën e saj penale dhe e kishte ndryshuar ankesën në mënyrë të tillë që veprimet e supozuara të bashkëshortit të saj ishin trajtuar si kundërvajtje dhe ajo nuk kishte kërkuar veprime të mëtejshme. Dy muaj pas kësaj ngjarjeje, burri i saj e kishte vrarë të bijën dhe djalin e saj. Para Gjykatës Evropiane, parashtruesja kishte pretenduar se policia, e vetëdijshme për sjelljen abuzive dhe kërcënuese të bashkëshortit të vet, nuk kishte ndërmarrë veprime të duhura që ta mbronte jetën e fëmijëve të vet. Ajo më tej ishte ankuar se nuk ishte e mundur që ajo të merrte kompensim. Gjykata Evropiane kishte konsideruar se kishte pasur shkelje të nenit 2 të Konventës Evropiane lidhur me dështimin e autoriteteve për të mbrojtur jetën e fëmijëve të parashtrueses dhe kishte vënë në dukje se situata në familjen e saj ishte e njohur nga policia vendore, duke pasur parasysh ankesën penale të nëntorit 2002 dhe thirrjet telefonike emergjente në dhjetor të vitit 2002. Gjykata po ashtu kishte konstatuar se kishte pasur shkelje të nenit 13 (e drejta për një zgjidhje efektive) të Konventës, pasi parashtruesja duhej të kishte qenë në gjendje të kërkonte kompensim për dëmin jomaterial, por asnjë mjet i tillë nuk kishte qenë në dispozicion të saj.

50. Gjykata Evropiane, në rastin e *Talpis kundër Italisë* (nr. 41237/14), që i referohet dhunës në familje, së cilës i ishte ekspozuar nëna e dy fëmijëve dhe që kishte rezultuar me vdekjen e djalit të saj dhe me vrasjen në tentativë ndaj saj, Gjykata kishte gjetur se kishte pasur shkelje të nenit 2, për shkak të vrasjes së djalit të saj dhe tentim-vrasjes kundër saj, kishte pasur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor, degradues dhe poshtërues), për shkak të dështimit të autoriteteve në detyrimin e tyre për të mbrojtur znj. Talpis kundër akteve të dhunës në familje, si dhe kishte pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës. Gjykata Evropiane kishte konstatuar se autoritetet kombëtare kishin dështuar të ndërmerrnin veprime efikase ndaj ankesës së parashtruar nga znj. Talpis dhe kishin krijuar një situatë të pandëshkueshmërisë së kryerësit të dhunës në familje, e cila kishte dërguar në përfundimin tragjik.
51. Në një situatë të krahasueshme me rastin që po trajtohet në këtë raport, viktimja L.Q., më 1 janar 2022 e kishte paraqitur rastin te autoritetet zyrtare dhe në procesverbalin e marrjes në pyetje, me numër të rastit 2022-BF-001, në Stacionin Policor në Skenderaj, viktimja kishte deklaruar për zyrtarët policorë, si në vazhdim: *“Që nga fillimi i martesës kam probleme me burrin sepse ushtron dhunë të vazhdueshme fizike, psikike, shpesh edhe tenton të më largon nga shtëpia, por rastet e mëhershme si kam raportuar në polici sepse kam menduar se ka ndonjë sëmundje mendore dhe po i kalon xhelozia që e ka ndaj meje.”* Po ashtu: *“Edhe ndaj fëmijëve është agresiv, vetëm se fëmija i rrinë larg se frikohen prej tij.”* Në pyetjen nëse kishte nevojë për urdhër mbrojtës të cilën kërkesë e ushtron Mbrojtësi i Viktimave përgjigja e të ndjerës ishte se *“Po kam nevoj për Urdher mbrojtës.”* Bazuar në këtë deklaratë, e ndjera i kishte njoftuar organet për rrezikun e vazhdueshëm që i kanosej.
52. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton qartë se vendimi për urdhër mbrojtjeje, ose për urdhër mbrojtjeje emergjente, ekzekutohet menjëherë me vendim përkatës, i shqiptuar nga gjykata kompetente dhe u dërgohet menjëherë kryerësit të dhunës në familje, Policisë së Kosovës, Qendrave për Punë Sociale, si dhe palëve të tjera në procedurë, duke specifikuar se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, me Ministrinë e Drejtësisë, me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, janë përgjegjëse për mbështetjen dhe për ngritjen e

strukturave ndihmëse dhe të infrastrukturës së nevojshme, që shërben për mbështetjen dhe për plotësimin e nevojave të personave kundër të cilëve është ushtruar dhuna në familje, përfshirë këtu asistencën sociale dhe shërbimet mjekësore, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Bazuar në hetimet e këtij rasti, nuk është ndërmarrë asnjë lloj procedure tjetër në kuptim të mbështetjes dhe ngritjes së strukturave ndihmëse, apo infrastrukturës së nevojshme, për mbështetjen dhe për plotësimin e nevojave të personave kundër të cilëve është ushtruar dhunë në familje, përfshirë këtu mosrespektimin e dokumentit “*Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje*”, i përpiluar nga Zyra për Barazi Gjinore e Zyrës së Kryeministrit, dhe mosofrimin e shërbimeve të tjera, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

53. Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar 2018, kishte shprehur vullnetin politik nëpërmjet Rezolutës Nr. 06-R-001 për miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ), duke shprehur kështu gatishmërinë për t’u angazhuar në zbatimin e Agjendës 2030, e cila bazohet në Rezolutën A/RES/70/1 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e miratuar më 25 shtator 2015.
54. Agjenda 2030 paraqet një plan veprimi të nivelit global, në linjë me të cilin shtetet kanë shprehur përkushtimin dhe përpiqen të jenë partnerë për t’i përmbushur 17 objektiva, me 169 caqe specifike të synuara, të cilave u korrespondojnë 231 tregues.
55. Objektivi 5 i Agjendës 2030 parasheh arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave, ndërsa treguesi 5.1 *“T’i ipet fund të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe vajzave në të gjithë botën.”* dhe 5.2 parasheh: *“Të eliminohen të gjitha format e dhunës kundër grave dhe vajzave në sferat publike dhe private, duke përfshirë trafikimin, shfrytëzimin dhe llojet e tjera të shfrytëzimit.”* Po ashtu edhe Objektivi 16 - Paqe dhe Drejtësi, Institucione të Forta, në treguesin 16.1, (indikatorët 16 1.1, 16 1.3 16. 1.4.), parasheh që: *“Të ulen në mënyrë të konsiderueshme të gjitha format e dhunës dhe niveleve përkatëse të vdekjeve kudo.”*

Konstatimet e Avokatit të Popullit

56. Avokati i Popullit konstaton se autoritetet shtetërore kanë dështuar në përmbushjen e obligimeve pozitive për të mbrojtje të drejtën në jetë.
57. Avokati i Popullit konstaton se përkundër faktit se nga viti 2013 është miratuar Procedura Standarde e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë,⁸ në të cilën janë përcaktuar edhe lista të kontrollit për veprimet që duhet t’i ndërmarrin autoritetet përgjegjëse, në rastin konkret këto procedura nuk janë respektuar.
58. Avokati i Popullit, bazuar në ato që u thanë më lart dhe në analogji me rastet nga GjEDNj-ja, konstaton se autoritetet nuk e trajtuan me vëmendjen e duhur rastin dhe nuk i ofruan mbrojtje adekuate viktimës.
59. Avokati i Popullit konstaton se ka munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve, gjë që shtron nevojën e përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të secilit institucion, prej

⁸ Shih linkun:

<https://abgj.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Procedurat%20Standarte%20t%C3%AB%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20n%C3%AB%20Familje.pdf>

momentit të paraqitjes së rastit të dhunës në familje e deri në përfundimin e tij. Shqiptimi i masave disiplinore mund të ketë efekt individual nëse është proporcional me shkeljen, por është e nevojshme që të synohet ndërtimi i politikave të qëndrueshme institucionale.

60. Edhe pse është përcaktim ligjor që prokurori i shtetit dhe zyrtarët policor që marrin pjesë në procedurë penale me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional të ushtrojnë detyrën, Avokati i Popullit konstaton se nuk është vepruar në përputhje me këto detyrime.
61. Avokati i Popullit konstaton se prokurori i rastit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë edhe përkundër faktit se është vënë në dijeni për rastin, nuk ka ndërmarr veprimet ligjore për vlerësimin e rrezikut dhe masave të sigurisë për viktimën.
62. Avokati i Popullit konstaton se zyrtarët policor në Stacionin Policor në Skenderaj, nuk kishin vepruar në përputhje me dispozitat e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Po ashtu, nuk kishin përpiluar ndonjë plan sigurie për viktimën dhe nuk kishin lëshuar masën për urdhër mbrojtjeje të përkohshme emergjente, derisa të fillonte punën gjykata.
63. Avokati i Popullit rikujton se, si pjesë përbërëse e parimit të sigurisë juridike, garantohet edhe parimi i pritjes legjitime. Pritjet legjitime mund të krijohen nga politikat publike, deklaratat publike dhe miratimin e praktikave të rregullta. Një pritje e ligjshme mund të cenohet edhe kur zyrtarët publik nuk arrijnë ta zbatojnë një politikë ose të ndjek një procedurë. Me gjithë numrin e madh të instrumenteve ndërkombëtare që janë të zbatueshme në vendin tonë, dhe akteve ligjore që i referohen mbrojtjes nga dhuna në familje, Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligjit për Barazi Gjinore, Kodin Penal, procedurave, si dhe në një morie të akteve të tjera, në këtë rast, nuk janë përmbushur pritjet legjitime.
64. Avokati i Popullit konstaton se justifikimi i autoriteteve përgjegjëse se viktima kishte deklaruar se ka përkrahjen nga familja nuk arsyeton mos ndërmarrjen e veprimeve nga këto autoritete.
65. Avokati i Popullit konstaton se në raport me numrin e rasteve në rritje të dhunës e veçmas të dhunës në familje vazhdon të ketë numër të pamjaftueshëm të mbrojtësve të viktimave, në këtë kontekst.
66. Avokati i Popullit konstaton se edhe për kundër ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal që ka ndodhë që nga viti 2019 me përkufizimin e dhunës në familje si vepër penale, këto ndryshime nuk janë përcjellë edhe me plotësimin e Procedurave Standarde të Veprimit për rastet e dhunës në familje.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“(…) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (…);* si dhe: *“Të rekomandojë (…)* nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.” (Neni 18, paragrafi 1.7).

Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

1. Policinë e Kosovës:


- *Në rastet e dhunës në familje, të gjitha stacionet policore, nëpërmjet zyrtarëve përgjegjës të veprojnë në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit.*
- *Në rastet të dhunës në familje zyrtarët përgjegjës të veprojnë në përputhje me nenin 24, paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Procedurat Standarde të Veprimit.*
- *Në të gjitha rastet e dhunës në familje që raportohen jashtë orarit të punës së gjykatave, policia pas vlerësimit të rrezikut të veproni në përputhje me nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Procedurat Standarde të Veprimit.*

2. Këshillin Prokurorial të Kosovës:

- *Të rishikohet procedura standarde e veprimit për rastet e dhunës në familje me qëllim që të ndërtohen politika të qarta dhe të qëndrueshme institucionale të vlerësimit real të rrezikshmërisë së rasteve dhe masat urgjente që duhen ndërmarrë për sigurinë e viktimës dhe parandalimin e dhunës në familje.*
- *Në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë të përgatis module të veçanta trajnimi për prokurorë për të ngritur kapacitetet përkritazi me trajtimin e rasteve të dhunës në familje me fokus vlerësimin e rrezikshmërisë dhe masat për sigurinë e viktimës.*
- *Të shtohet numri i mbrojtësve të viktimave në raport me numrin e rasteve në rritje të dhunës, e veçmas të dhunës në familje.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,


Naïm Qelaj

Avokat i Popullit